



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### K R Y E T A R I

---

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

Nr. 688/11 Prot.

Tiranë, më 29/12/2017

### V E N D I M

***Nr. 208, Datë 29/12/2017***

### PËR

### **EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

#### **"Cilësia e godinave të shkollave parauniversitare"**

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 688/1, datë 09.10.2017 realizoi auditimin e performancës me temë "Cilësia e godinave të shkollave parauniversitare". Ky auditim u programua për t'u ushtruar konkretisht Bashkinë Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Vlorë, si dhe u shtri edhe në Bashkitë Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Kukës, Lezhë. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 688/8, datë 25.11.2017 u dërgua projekt-raporti i auditimit në Bashkinë Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Vlorë si dhe në formë elektronike Bashkive Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Kukës, Lezhë të përfshira në këtë auditim, për të përthithur sa më shumë opinione dhe observacione në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të sistemit arsimor, me fokus kryesor "Cilësia e godinave të shkollave parauniversitare".

Gjithashtu në këtë auditim, hartimi i programit, auditimi, projekt-raportit dhe raportit i këtij auditim, është realizuar edhe me ndihmesën e në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Kombëtare të Auditimit (SAO) të Republikës së Kroacisë, (B V-Antic/Assistant Auditor General, SAO Croatia & S D /Head of the Department, SAO Croatia) në kuadër të Projektit të Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri", me financim të fondeve IPA 2013 të Bashkimit Evropian.

Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh të dhënat sipas pyetësorëve dhe shpjegimeve të dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimin.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin e Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga institucionet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10, 13, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" .

### **KONKLUDOVA:**

Në politikat shoqërore të një vendi, vend të rëndësishëm zë ngritja e një sistemi sa më cilësor të arsimit.

*Njeriu para së gjithash duhet të mësojë shkallën e paditurisë së tij.*

***Sami Frashri***

Roli i arsimit është parësor për çdo vend që synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, kulturor dhe social dhe ai gjatë gjithë jetës është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie të tillë. Arsimi pajis nxënësit me njohuri, shkathtësi vlera dhe qëndrime që iu mundësojnë atyre t'i plotësojnë nevojat e të sotmes dhe sfidat e së nesërme.

Arsimimi dhe shkalla e tij është e lidhur ngushtësisht edhe me ndërtesat shkollore, të cilat kanë ndikimin e tyre shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij procesi kaq delikat. Nga rëndësia mjaft e madhe që kanë ndërtesat e shkollave në edukimin e fëmijëve, shpesh janë quajtur si "mësuesi i tretë". Hapësirat e shkollës, ku fëmijët kalojnë pjesën më të madhe të ditës, përcakton mënyrën se si ata reagojnë brenda këtij dimension, e ndikon drejtpërsëdrejti në sjelljen e tyre, procesin e marrjes e dhënies së mësimi e gjithashtu në kushtet shëndetësore të tyre. Asnjë godinë nuk lidhet aq fort e nuk ndikon aq shumë sa ndërtesat e shkollave tek nxënësit, komuniteti dhe pamja urbane. Pikërisht rëndësia që ka ndërtesa e shkollës dhe numri i madh i strukturave shkollore që ekzistojnë, rikonstruktohen e që kërkojnë të ndërtohen në të ardhmen, lind nevojën që të njohim, të kuptojmë e të arsyetojmë mbi evoluimin, historikun e tipologjitë e tyre në mënyrë që mos përsërisim gabimet e të shkuarës në të ardhmen. Ndërtesat shkollore kanë një zhvillim të ulët nga pikëpamja cilësore, megjithëse këto vitet e fundit ka patur një rritje sasiore për shkak të disa politikave stimuluese që kërkojnë domosdoshmërisht të ushtrojnë një "presion" pozitiv në nivelet politike për të kaluar nga "riparimet e pjeshme sipas nevojave të çastit" drejt "zgjdhjeve të plota e afatgjata".

Ndërmjet këtij auditimi jemi munduar të skicojmë dhe adresojmë rrugën për përmbushjen dhe plotësimin e përparësive strategjike gjithëpërfshirëse të faktorit "Ndërtesë" në arsimimin e nxënësve, kaq të rëndësishëm për sigurimin e mbarëvajtjen e këtij procesi kaq delikat. Gjithashtu, kemi kërkuar të promovojmë bashkëveprimin ndërmjet qeverisjes qendrore, pushtetit vendor, shoqërisë civile, grupeve të interesuara, komunitetit të biznesit dhe publikut

të gjerë, se rritja e performancës së vendit ku zhvillohet procesi mësimor është investimi që ndikon në zhvillimin tërësor të vendit.

Nëpërmjet auditimit të performancës KLSH synon të promovojë **përmirësime në performancën e shërbimeve publike**. Filozofia e re drejtuese në KLSH e ka vënë auditimin e performancës në qendër të vëmendjes si motor të zhvillimit institucional. Misioni i KLSH-së në Planin Strategjik 2013-2017 përkufizohet: **“Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike”**, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu KLSH tashmë ka promovuar një përvojë të re nëpërmjet auditimit të performancës, atë të realizimit të auditimeve të përbashkëta si një mundësi e pazëvendësueshme për të avancuar si dhe përfitimit nga përvojat e përbashkëta për të përmirësuar cilësinë e këtij auditimi, i cili ndonëse është i ri për këtë institucion, vetëm pesë vjeç, po ecën me hapa të sigurta e të shpejta në zhvillimin e tij. Në këtë kontekst, KLSH e ka kryer këtë auditim në bashkëpunim të ngushtë edhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit (SAO) të Republikës së Kroacisë, (B V-Antic/Assistant Auditor General, SAO Croatia & S D/Head of the Department, SAO Croatia) në kuadër të Projektit të Binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri”, me financim të fondeve IPA 2013 të Bashkimit Evropian.

Godinat shkollore parauniversitare kanë marrë vëmendjen e duhur këto vitet e fundit kryesisht në drejtim të rritjes së cilësisë tyre, megjithatë ajo vazhdon të ndeshet me problematikat, që kanë të bëjnë me;

- përcaktimin e legjislacionit dhe përgjegjësitë, kompetencat, vendim-marrjen, nëpërmjet bashkëpunimit midis institucioneve qendrore;
- përcaktimi i fushave të përgjegjësisë ndërmjet institucioneve qendrore e lokale;
- mungesën e strategjisë për godinat shkollore parauniversitare;
- mungesën e studimeve për ndërtimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e godinave shkollore parauniversitare;
- marrëdhënie të dobëta e inefektive të partneritetit me palët e interesit;
- hartimin e projekteve jociësore në ndërtimin dhe rikonstruksione e objekteve arsimore;
- mungesën e praktikave më të mira që sjellin risi dhe modernizim;
- mungesën e shkollave dhe amortizimi i tyre;
- mungesën e mjediseve shkollore, klasa, laboratorë, palestra, ndërtimet pa leje në ambientet shkollore, zënia e ambienteve shkollore dhe të oborreve të tyre;
- mungesën e vlerësimit dhe certifikimit të tyre sipas standardeve evropiane në hapësira, në numër nxënësish, ventilim dhe ajrim të klasave, ndriçimit të tyre në kushtet natyrale dhe nëpërmjet dritës elektrike, etj.;
- mungesën e vlerësimit të shkollave sipas karakteristikave dhe standardeve të tyre në përputhje me ciklet e mësimdhënies si të arsimit fillor, nëntë-vjeçar dhe të mesëm;
- mungesën e përcaktimit e nevojave dhe prioriteteve si për godina të reja shkollore, ashtu dhe rikonstruksionin e tyre cilësor në funksion të kohës;
- mungesën e përcaktimit të kostove për çdo shkollë për mirëmbajtjen dhe miradministrimin e tyre;

- etj.

KLSH tashmë ka promovuar një përvojë të re nëpërmjet auditimit të performancës, atë të realizimit të auditimeve të përbashkëta si një mundësi e pazëvendësueshme për të avancuar në auditimet e performancës, për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal, si dhe përfitimit nga përvojat e përbashkëta për të përmirësuar cilësinë e këtij auditimi, i cili ndonëse është i ri për këtë institucion, vetëm pesë vjeç, po ecën me hapa të sigurta e të shpejta në zhvillimin e tij. KLSH ashtu si dhe Institucionet Supreme të Auditimit të rajonit e më gjerë, gjithnjë e më tepër, ka kuptuar se sa e rëndësishme është të mësojmë nga njëri-tjetri, në mënyrë që të jemi në një hap me ndryshimet e shpejta që ndodhin në sektorin e menaxhimit publik, në standardet e auditimit apo të financave, si dhe me pritshmërinë që ka publiku për punën tonë audituese. Në këtë kontekst, KLSH e ka kryer këtë auditim në bashkëpunim të ngushtë edhe me Zyrën Kombëtare të Auditimit (SAO) të Republikës së Kroacisë, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri”, me financim të fondeve IPA 2013 të Bashkimit Evropian.

Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me cilësinë e godinave shkollore si institucione të arsimit dhe formimit të brezit të ri në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke bërë vlerësimin e reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe pushteti vendor, mbi performancën e shkollimit në Shqipëri, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm dhe promovuar eksperiencë efikase në zhvillimin e gjithanshëm të tij. Auditimi gjithashtu do të bazohet në parimin e partneritetit Qeveri – Pushtet vendor – Arsimim dhe do të ndërtohet në frymën e konstruktivitetit dhe të bashkëpunimit mes tyre. Në konkluzione do të pasqyrohet mendimi më bashkëkohor ku nevojat për një arsim më cilësor janë të lidhura ngushtë edhe me cilësinë e godinave shkollore.

Auditimi është përqendruar pikërisht dhe kryesisht në rezultate, po aq sa edhe në procese, duke theksuar nevojën për ndryshim e përmirësim të vazhdueshëm me synimin që të trajtojë një përpjekje e angazhim profesional, për të siguruar mirëkuptimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, garantuar dhe ndihmuar sistemin e arsimit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie që u siguron nxënësve të ardhmen e tyre.

**Qëllimi i auditimit:** është përmirësimi i mirëkuptimit të aktorëve të ndryshëm, për të kontribuar në zhvillimin e sistemit të arsimit dhe identifikimin e nevojave, që tu sigurojë nxënësve, një proces mësimor në kushte sa më të mira.

**Objektivi i auditimit:** është pasqyrimi me realizëm dhe objektivitet i situatës së godinave shkollore duke analizuar problematikën dhe instrumentet që strukturat shtetërore kanë në dispozicion për të përmirësuar situatën.

**Rëndësia e auditimit:** është të bëjë vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit e dhe ndihmuar sistemin e arsimit për një mësimdhënie dhe mësimnxënie që u siguron nxënësve të ardhmen e tyre.

**Mesazhi kryesor i këtij auditimi është:** “Nxitje e reformave për vlerësimin e cilësisë së godinave shkollore parauniversitare, duke i cilësuar si “mësuesi i tretë” për ndikimin e tyre shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit aq delikat të mësimdhënies e mësimnxënies në sistemin e arsimit.

Sot sfida për arsimim sa më cilësor gjithëpërfshirës e të barabartë qëndron në rritjen bashkëpunimit të gjithanshëm të institucioneve qendrore e vendore, sipërmarrjeve e bizneseve, partnerëve të tjerë zhvillimorë, publikut, etj., për të kërkuar e përshtatur edhe lidhjen e godinave shkollore me shkallën arsimore, për të ndërtuar një sistem të godinash shkollore të hapur me zhvillimet e teknologjinë bashkëkohore që të lehtësojë arsimimin, sot e në të ardhmen në përputhje me sistemin e BE.

Nëpërmjet këtij auditimi ne kërkojmë që investimet në infrastrukturën shkollore të jenë të orientuara jo vetëm nga emergjencat dhe zgjidhja e tyre, por drejt prioriteteve, cilësisë së tyre, rritjes së fondeve për arsimin parauniversitar, duke i afruar ato me vendet e rajonit dhe me mesataren e vendeve të BE, për një arsim sa më cilësor dhe krijimit të kushteve për të mësuar gjatë të gjithë jetës. Arritjen e kryerjes së studimeve gjithëpërfshirëse mbi rentabilitetin dhe të përshtatshmërisë për të gjykuar mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit, qeverisë, nxënësve, të rinjve, individëve, dhe sipërmarrjeve e biznesit në fushën e arsimit i cili të bazohet në:

- parimet e vlerës për para;
- në përputhshmërinë e sistemit të arsimit me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të tij;
- rentabilitetin ekonomik të mundshëm;
- aftësinë e sistemit për të tërhequr financime buxhetore e financime private;
- Aftësinë e sistemit për të shlyer detyrimet

Godinat shkollore të sistemit parauniversitar, si objekte në të cilat mësojnë nxënësit dhe punojnë mësuesit e personeli ndihmës, duhet të plotësojnë standardet për objektet shkollore në shumë aspekte, si pozicioni, orientimi, ndriçimi, ajrosja e hapësirave, ngrohja dhe mirëmbajtja e higjienës në objektin shkollor si dhe orenditë, mjetet mësimore ndihmëse dhe mbingarkesa në programit mësimor, sepse ato ndikojnë direkt në shëndetin fizik të nxënësve.

Për të gjitha këto apo dhe të tjera duhet të kryhen studime që të konsistojë në zhvillimin e politikave dhe hapave ligjorë që duhen ndërmarrë për reformimin dhe modernizimin menaxhimit të godinave shkollore në sistemin e arsimit parauniversitar, përcaktimin e kriterëve të përgjithshme, organizimin dhe funksionimin e institucioneve, në përputhje me kërkesat e perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, normave dhe standardeve dhe drejtimeve evropiane të zhvillimit të vendit. Për të gjitha këto Bashkitë në bashkëpunim me Qeverinë duhet të marrin masa për të plotësuar të gjitha boshllëqet ligjore dhe institucionale duke bërë dhe përmirësimet përkatëse në mënyrën e menaxhimit të godinave shkollore parauniversitare në sistemin e arsimit e cila duhet të përqendrohet në:

- përmirësimi i cilësisë së ligjit ekzistues;
- përcaktimit të saktë dhe të plotë mbi vartësitë e sistemit të arsimit dhe menaxhimit të administrimit të godinave shkollore;
- përcaktimit të përgjegjësive dhe kalimit të kompetencave dhe pronësive të sistemit të godinave të arsimit parauniversitar nga qeverisja vendore;
- përmirësimin e të gjithë kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me këtë sistem përmes rritjes së bashkërendimit të legjislacionit dhe heqjes së pengesave të ndërmjetme;
- përgatitjen e infrastrukturës dhe personelin administrues që merret me sistemin e godinave të arsimit parauniversitar ;

- përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit dhe administrimit të godinave të arsimit parauniversitar;
- përcaktimin e strukturave përkatëse nga nivel qendror e deri tek niveli më i ulët të cilat do të merren jo vetëm me politikat e tij por edhe me administrimin e gjithë këtij sistemi;

Auditimet e performancës në KLSH udhëhiqen nga Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, Manuali i tij, Indikatorët e tyre si dhe Hartat Konjitive të cilat konsiderohen si dokumente dinamikë, që përditësohen me progresin praktik. Ato nuk janë thjesht dokumente normative apo teknike, apo një referencë e shpejtë, por përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh me implikime praktike, që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Udhëzimet e reja të auditimit të performancës në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI 3000-3100) nxisin një orientim drejt nevojave të qytetarëve.

### ***Mangësitë dhe konkluzionet e këtij auditimi janë:***

#### **Gjetje**

- ✘ Megjithëse ekzistojnë standarde dhe norma për ndërtimin e shkollave apo godinave shkollore nga auditimi i ndërtesave shkollore në përgjithësi rezulton se:
  - madhësitë e tyre shpeshherë janë shumë të vogla për numrin e nxënësve, gjë që bën që në shumë shkolla të organizohet mësim në dy apo tri ndërrime,
  - vendndodhja e tyre është në distanca të papërshtatshme nga fshatrat,
  - klasat e specializuara të mësimit shumë shpesh mungojnë për nivelet e mesme,
  - shumë ndërtesa shkollore janë në kushte jo të mira fizike;
  - në disa zonat rurale ku popullsia është e shpërndarë, sistemi i arsimit zhvillohet në “klasa të bashkuara” ku janë brenda edhe cikli fillor i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë (niveli fillor me klasat 1 deri 5).
  - shumë shkolla nuk i posedojnë laboratorë që korrespondojnë me kurrikulat, kështu mësimdhënësit japin vetëm mësim teorik.
- ✘ godinat shkollore parauniversitare ekzistuese të shpërndara në të gjithë vendin si në zonat rurale dhe urbane janë në mbi 90 % e tyre 40-60 vjeçare, të konceptuara mbi të tjera standarde të cilat nuk përafrohen me standardet që kërkon koha dhe me ato të BE;
- ✘ pothuajse të gjitha bashkitë kanë mënyrë menaxhimi të sistemit të godinave shkollore të ndryshme nga njëri tjetri duke krijuar vështirësi në bashkërendimin e veprimeve;
- ✘ sistemi i arsimit ka varësi të dyfishtë nga DAR dhe bashkitë e rretheve të cilat nuk i kanë në kompetencat plotësisht të ndara;
- ✘ sipas strategjisë por dhe plotësisht të pyetësorëve nga bashkitë pranohet se, financimi i sistemit të arsimit parauniversitar përballet me sfida si:
  - niveli jo i kënaqshëm i financimit të arsimit parauniversitar, kundrejt objektivave të miratuar në programin e Qeverisë, për të realizuar funksionet e përcaktuara me ligj;
  - kapacitete të munguara për menaxhim financiar në nivelet e njësisë arsimore vendore / njësisë bazë të qeverisjes vendore/institucionit arsimor;

- mos përcaktimi në aneks më vete i transfertës së pakushtëzuar që përfitojnë NJBQV-të në ligjin vjetor të buxhetit, që përdorimi i fondeve për arsimin të realizohet sipas formulës “fonde për nxënës”;
  - kujdes i pamjaftueshëm nga NJBQV për të realizuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar, sipas nenit 28 të ligjit nr. 69/2012;
  - reagim i ngadaltë i sektorit publik për të mbështetur me investime shtimin e godinave dhe të mjediseve shkollore;
  - migrimi nga fshati në qytet ka bërë që shkollat në qytete dhe në zonat periferike urbane të punojnë mbi kapacitetin e tyre;
  - nivel jociësor i hartimit të projekteve për ndërtime dhe rikonstruksione të objekteve arsimore (ndërtimet e reja dhe rehabilitimet janë në pronësi dhe në administrim të plotë të NJBQV-ve dhe, në disa raste, janë bërë edhe kur studimet parashikonin që këto shkolla të bashkohen me shkolla të tjera).
  - mos shoqërimi i investimeve të realizuara në arsim (që janë fokusuar kryesisht në ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore-ndërtime të reja dhe rehabilitime) edhe me mjetet didaktike, laboratorë informatike etj., të nevojshme;
  - mungesa e autonomisë ligjore reale së institucioneve arsimore për realizimin/arkëtimin e të ardhurave të siguruara nga prindërit, biznesi, si dhe donatorët e ligjshëm për plotësimin e nevojave të tyre, menaxhimin/mbartjen e fondeve, si dhe transferimin nga viti pasardhës;
  - pamundësia për çeljen e llogarive bankare për çdo shkollë, për të siguruar menaxhim autonom të buxhetit për mallra dhe shërbime arsimore, për përcaktimin e buxheteve shkollore sipas formulës për planifikimin e buxhetit shkollor, që të përputhet me sistemin e buxhetimit të MF-së;
  - infrastruktura e dobët e sistemit rrugor dhe e transportit që nuk mundëson përqendrimin e shkollave, duke rënduar koston e shërbimit arsimor; në disa zona rurale raporti nxënës/mësues është shumë i ulët, një punonjës mësues për 10 nxënës.
- ✘ strukturat përgjegjëse për sistemin e godinave shkollore parauniversitare nuk e njohin plotësisht strategjinë e MASR për arsimin edhe me pretendimin se ajo është kompetence e drejtorive arsimore në rrethet DAR të cilat janë në varësi të MASR dhe merren me politikën e arsimit;
  - ✘ nuk ka strategji dhe objektiva në drejtim për menaxhimin dhe administrimin e godinave shkollore parauniversitare në drejtim të edukimit mësues dhe zhvillimit të nxënësve në përputhje me kërkesat e kohës, përveç Bashkisë Tiranë cila një ka studim fizibiliteti “Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë e Tiranë” që do të konsistojë në ndërtimin e disa shkollave të reja në bazë të standardeve bashkohore;
  - ✘ Gjithashtu nga auditimi dhe marrja e opinionëve nëpërmjet bashkëbisedimeve me specialistë të fushës dhe përgjigjet e pyetësorëve për sistemin e godinave shkollore parauniversitare rezultojnë se:
    - nuk është përmirësuar ndarja e saktë e kompetencave si një ri konceptim për mbështetje financiare të sistemi arsimor parauniversitar i cili ka ndërvarësi

- institucionale midis bashkisë dhe DAR, MASR, MF gjë që reflektohet dhe tek sistemi i godinave shkollore, pajisjeve, terreneve sportive, etj.;
- ndërvarësitë dhe kompetencave ligjore për sistemin e shkollave profesionale kanë ndryshuar këtë periudhë nga MAS në MMSR dhe së fundi në varësi me MF si dhe gjë e cila ka krijuar vështirësi në mirë menaxhimin e tyre;
  - bashkitë nuk kanë zyra të veçanta si planifikues dhe monitorues i mbarëvajtjes së sistemit të godinave shkollore, bazë ligjore të veçantë për rregullimin e veprimtarisë së tyre, sepse kanë mënyra të ndryshme të menaxhimit të godinave shkollore dhe ndërvarësi institucionale në disa drejtori brenda institucionit të bashkisë;
  - bashkitë nuk paraqesin të dhëna ku të jenë të përcaktuara drejtimet, politikat për reformimin dhe modernizimin e administrimit të sistemit të godinave shkollore parauniversitare tuaj, në përputhje me drejtimet e strategjinë e Qeverisë apo në përputhje me drejtimet e strategjinë e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë, por vetëm thonë se jemi në një drejtim me to;
  - bashkitë nuk paraqesin të dhëna ku të jenë të përcaktuara drejtimet, politikat për reformimin dhe modernizimin e mbarëvajtjes së sistemit të godinave shkollore parauniversitare, si institucioni që merret me administrimin e tyre përveç Bashkisë Tiranë e cila paraqet studimin e fizibilitetit për ndërtimin e disa shkollave te reja cituar dhe me sipër;
  - bashkitë nuk paraqesin të dhëna ku të kenë audituar apo matur plotësimin e standardeve dhe kriterëve në sistemin e godinave shkollore parauniversitare në bazë të normave dhe kapacitetet e shkollave;
  - bashkitë nuk paraqesin të dhëna ku të kenë audituar apo matur performancës e shërbimit të ofruar nga sistemi i godinave parauniversitare në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies, shërbimit të ofruar nga sistemi i godinave parauniversitare në drejtim të ofrimit të kapaciteteteve, laboratorëve, terreneve apo palestrave sportive në shkollat e sistemit parauniversitar ;
  - bashkitë nuk kanë dijeni a monitorojnë strukturat në vartësi të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, administrimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare;
- ✘ institucionet përgjegjëse në bashkitë e vendin nuk kanë bërë një planifikim të mirë të sasisë dhe vlerës apo (kostos) së mirëmbajtjes, restaurimit dhe të ndërtimeve të reja, për godinat shkollore parauniversitare, të domosdoshme për një zhvillimin normal të procesit mësimor sipas drejtimeve të tij, ato realizohen në bazë të kuotave të një viti më parë ose të buxheteve të planifikuara dhe realizuar në një vit më parë;
- ✘ nuk ka studime mbi analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë për të gjykuar mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit, qeverisë, nxënësve, të rinjve, prindërve, dhe sipërmarrjeve e biznesit në fushën e sistemit të godinave shkollore parauniversitare e cila të bazohet në:
- parimet e vlerës për para;
  - në përputhshmërinë e sistemit të arsimit me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të tij;
  - rentabilitetin ekonomik të mundshëm;
  - aftësinë e sistemit për të tërhequr financime buxhetore e financime private;



- ✘ fondet për furnizimin me bazë materiale të laboratorëve ku realizohen praktikat mësimore pothuajse janë të pamjaftueshme po të kihet parasysh dhe nevojat që kanë institucionet e këtij sistemi dhe për materiale të tjera;
- ✘ fondet në zërin investimeve janë minimale duke patur parasysh nivelin jo të mirë në të cilin ndodhen laboratorët e praktikave mësimore si nga ambientet ashtu dhe pajisjet të cilat duhet të rinovohen në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e kohës.
- ✘ të gjitha bashkitë nuk zotërojnë apo nuk paraqesin dokumentacion të akteve të pronësisë së institucioneve të arsimit parauniversitar konform legjislacionit në fuqi;
- ✘ në përgjithësi në shkolla mungojnë edhe si ambiente laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, gjeografisë, etj.;
- ✘ mos bashkërendimi i mirë i kompetencave për fondet në krijimin e laboratorëve të shkollave me fondet për zhvillimin e proceseve mësimore në laboratorë ndërmjet MASR dhe NJQV;
- ✘ mungesa e palestrave, terreneve sportive në territorin e jo në përgjithësi në parametra e standardeve në sistemin e godinave shkollore parauniversitare;
- ✘ ka fonde të pamjaftueshme në drejtim të përmirësimit të sistemit të godinave shkollore parauniversitare ;
- ✘ godinat dhe ndërtesat e shkollave janë krijuar e vazhdojnë të mbeten kryesisht, në të njëjtat forma prej shumë kohësh;
- ✘ ndërtesat edukative duhet të shihen si një koleksion mjedisesh, grumbullim hapësirash të cilat influencojnë mësimin, mësuësin, nxënësit, etj.;
- ✘ arkitektura e shkollave në vendin tonë është derivat i modeleve të vjetra, të ngurta, jo fleksible, dhe jashtë parametrave të komoditetit; modele të papërshtatshme me ndryshimet drastike në sektorin e edukimit, të teknologjisë, pedagogjisë, politikës e shoqërisë;
- ✘ Sistemi i godinave të arsimit parauniversitar në vendin tonë ka një shpërndarje të madhe gjeografike si në zonat rurale ashtu dhe urbane por ka shumë institucione të arsimit në zonat rurale të cilat kanë një numër të ulët banorësh për shkak të lëvizjeve të popullsisë drejt qendrave urbane;
- ✘ strukturat përgjegjëse të bashkive kanë disa mangësi në administrimin dhe menaxhimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare si:
  - janë njësi amorge, pa ndarje kompetencash dhe përcaktim rolesh të qarta mes saj dhe drejtorive të tjera;
  - vendimet ato i marrin mbi bazën e kushteve emergjente dhe jo mbi një proces planifikimi;
  - nuk kanë politika të veçanta për matjen dhe përdorimin me ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve që i vihen në dispozicion;
  - nuk kanë qasje analitike llogaridhënëse në aspektin e gjenerimit dhe përdorimit të matësve për vlerësimin e përshtatshmërisë së rikonstruksioneve, meremetimeve apo investimeve në sistemin e godinave në raport me objektivat e procesit mësimor apo edhe ato të strategjisë së arsimit parauniversitar;
  - nuk kanë bashkëpunim me grupet e interesit në identifikimin e problemeve/nevojave në administrimin e sistemit të godinave;

- në përgjithësi ndërhyrjet në sistemin e godinave arsimit parauniversitar nuk janë bërë duke vlerësuar prioritetet por kryesisht duke zgjidhur ato më emergjentet;
- nuk kanë plane veprimi në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat për sistemin e godinave shkollore parauniversitare;
- nuk paraqesin tregues mbi matjen e përshtatshmëritë të meremetimeve, restaurimeve dhe investimeve të kryera në sistemin e godinave të arsimit parauniversitar me objektivat e strategjisë së arsimit parauniversitar;
- nuk është vënë si një nga objektivat kryesore të bashkive për sistemin e godinave shkollore parauniversitare termoizolimi i tyre nga jashtë me material termoizolues;
- ✘ rezulton se ka mangësi në sistemin e godinave shkollore parauniversitare krahasuar me normat, standardet dhe kriteret në drejtim të:
  - Kapaciteteve;
  - Madhësi të Klasave;
  - Numër nxënës për Klasë;
  - Kushteve të Ndërtimit;
  - standardeve për ndërtimin e objekteve të ujit dhe kanalizimeve;
  - Hapësirave jo- akademike;
  - Hapësirave sportive;
  - Gjendjes së elektricitetit dhe ndriçimit;
  - Gjendjes së ndriçimit artificial;
  - Sistemeve të Ngrohjes në Ndërtesat e Shkollave;
  - Efikasitetit të energjisë;
  - Burimeve të ngrohjes;
  - Transportit;
  - Mobilimi, orenditë dhe aparaturat në shkolla.
- ✘ Nuk ka plan veprimi për sistemin e godinave shkollore parauniversitare arsimit në bashkëpunim me bashkitë për evidentimin e profesioneve sipas nevojave dhe prioriteteve të tyre;

### **Konkluzione:**

- Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor i cili është i lidhur ngushtësisht me menaxhimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare, sidomos sot kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.
- Përmirësimi dhe unifikimi i administrimit të godinave në sistemin arsimor parauniversitar për të gjitha bashkitë e vendit duhet kryer apo realizuar, mirë sepse është e nevojshme të ketë një zgjidhje që ti rezistojë kohës e të mundësojë qasjen më efektive dhe gjithëpërfshirëse në këtë fushë, duke u mbështetur në:
  - vlerësimet dhe zbatimin e legjisllacionit të mëparshëm, në bazë të përvojës së fituar;
  - përvojën e të punësuarve në institucionet e sistemit të arsimit që ballafaqohen çdo ditë me probleme;
  - konsultime individuale dhe me përfaqësues të gjitha institucioneve e ministrive, grupeve të interesit që përfaqësojnë sektorin joqeveritar/civil në lidhje me sistemin e arsimit;

- bashkëpunim me partnerë privatë dhe organizata jo qeveritare (OJQ) potenciale të shquara e të njohura të cilat me përvojën dhe kapacitetin e tyre mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme si në përcaktimin ashtu edhe në implementimin e qëllimeve dhe masave të përcaktuara për përmirësimin e sistemit të arsimit;
- konsultim dhe me strategji e dokumente tjera rajonale, që kanë të bëjnë me arsimin në vendet e tjera evropiane, në mënyrë që njohuritë e këtyre vendeve të përdoren për të dhënë rezultatet më të mira të mundshme në sistemin e arsimit.
- Hartimi i strategjive dhe përmirësimeve ligjore mbi mënyrën e menaxhimit dhe administrimit të godinave shkollore prauniversitare të sistemit arsimit duhet të realizohet për të siguruar që shkolla, si objekte në të cilat mësojnë nxënësit dhe punojnë mësuesit e personeli ndihmës, duhet të plotësojnë standardet për objektet shkollore në shumë aspekte, si pozicioni, orientimi, ndriçimi, ajrosja e hapësirave, ngrohja dhe mirëmbajtja e higjienës në objektin shkollor si dhe orenditë, mjetet mësimore ndihmëse dhe mbingarkesa në programit mësimor, sepse ato ndikojnë direkt në shëndetin fizik të nxënësve.
- Kryerja e studimeve dhe zhvillimi i politikave për reformimin dhe modernizimin menaxhimit të godinave shkollore në sistemin e arsimit parauniversitar, në përcaktimin e kriterëve të përgjithshme, organizimin dhe funksionimin e institucioneve, në përputhje me kërkesat e perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, normave dhe standardeve e drejtimeve evropiane të zhvillimit të vendit, sepse kanë ndikim në:
  - përmirësimin e cilësisë së ligjit ekzistues;
  - përcaktimin e saktë dhe të plotë mbi vartësitë e sistemit të arsimit dhe menaxhimit të administrimit të godinave shkollore;
  - përcaktimin e përgjegjësive dhe kalimit të kompetencave dhe pronësive të sistemit të godinave të arsimit parauniversitar nga qeverisja vendore;
  - përmirësimin e të gjithë kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me këtë sistem përmes rritjes së bashkërendimit të legjislacionit dhe heqjes së pengesave të ndërmjetme;
  - përgatitjen e infrastrukturës dhe personelin administrues që merret me sistemin e godinave të arsimit parauniversitar ;
  - përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit dhe administrimit të godinave të arsimit parauniversitar;
  - përcaktimin e strukturave përkatëse nga nivel qendror e deri tek niveli më i ulët të cilat do të merren jo vetëm me politikën e tij por edhe me administrimin e gjithë këtij sistemi;
- Përshtatja, përmirësimet ligjore dhe plotësimi i strategjisë për sistemin godinave arsimore parauniversitare bëjnë që ky sistem të ecin me ritmin e kohës, duke e reformuar nëpërmjet adresim të plotë të fenomeneve që rregullojnë organizimin, funksionimin, institucionalizimit, rritjen e cilësisë, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit, të tij në funksion të transformimit të sistemit të arsimit.
- Puna e bërë për rivitalizimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare, për t'u përshtatur ndryshimeve shoqërore duhet të jetë; një proces dinamik dhe i vazhdueshëm, me objektiva të përcaktuara, për të përshtatur sa më tepër të jetë e mundur ofertën me kërkesat e ndryshimeve shoqërore dhe lëvizjet e popullsisë; ndryshimet e përshtatja e sistemit duhet të jetë një proces dinamik dhe i vazhdueshëm sepse teknologjia dhe

ekonomia janë gjithnjë në evoluim; ofertat e ofruesve të jetë sa më cilësore dhe mundësisht ti paraprijë kërkesave të teknologjisë nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të përmbajtjes kurrikulare dhe programeve, kualifikimit të burimet njerëzore, kompletimit me infrastrukturë më moderne etj.,

- Pa një sistem mëndje hapur menaxhimi e administrimit të sistemit të godinave shkollore parauniversitare do të jetë i pamundur trajtimi dhe zgjidhja e shumë problemeve, të cilat kanë ngadalësuar përparimin në drejtimin cilësor të sistemit të arsimit në vendin tonë.
- Zhvillimi normal i procesit mësimor realizohet cilësisht sipas objektivave vetëm duke patur ambiente shkollore të përshtatshme e cila mund të arrihet edhe duke përcaktuar drejtë saktë koston që duhet për çdo lloj materiali që do të duhet për mirëmbajtjen dhe restaurimin apo dhe ndërtimin e godinave të reja, gjithashtu është e domosdoshme dhe për programim sa më të saktë të fondeve buxhetore që duhen por edhe kërkesave që mund tu bëhen donatorëve të ndryshëm për fonde;
- Me mirëmbajtjen e duhur të objektit shkollor, me shfrytëzimin racional të burimeve energjetike dhe me instalimin e materialeve me ekonomikitet energjetik, shkolla do të kurseje energji, çka do të thotë se do të harxhojë me pak mjete financiare gjatë aktivitetit të saj, të cilat mund të investohet në përmirësimin e kushteve për të qëndruar në shkollë, si dhe në modernizimin dhe zhvillimin e procesit arsimor;
- Përcaktimi i kostove është e domosdoshme për çdo drejtues të suksesshëm dhe bazë e mirë për të garantuar një ecuri cilësore, të qëndrueshme, afatgjatë të mësimdhënies dhe mësim nxënies gjatë realizimit të procesit mësimor;
- Mungesa e fondeve çon në zhvillimin me mangësi të procesit mësimor dhe aq më tepër në realizimin e laboratorëve mësimor aq të nevojshme për një mësim nxenie cilësore;
- Mirëmbajtja e objekteve shkollore që të organizohen dhe të veprojnë në mënyre të dobishme, duhet të bëhet në bazë të një plani për mirëmbajtje, i cili duhet ti përgjigjet katër pyetjeve – CFARË? KUR? KUSH? SI? Nëse përgjigjet e këtyre katër pyetjeve jepen saktë, evidentohen qartë dhe zbatohen në mënyrë praktike, atëherë mirëmbajtja e sistemit të godinave shkollore parauniversitare do të jetë shumë më i suksesshëm. Mirëmbajtja e godinave shkollore parauniversitare i mbron investimet kapitale, kujdeset për shëndetin dhe për sigurinë e fëmijëve dhe të punësuarve dhe siguron kushte për zhvillimin e procesit arsimor;
- Faktorë të ndryshëm në procesin arsimor kanë role dhe përgjegjësi të ndryshme në mirëmbajtjen e sistemit të godinave shkollore parauniversitare e konkretisht:

*Zyrat përgjegjëse e ngarkuar për sistemin e mirëmbajtjes së godinave shkollore duhet ta dinë se:*

- ✓ mirëmbajtja e objekteve shkollore kontribuon për mirëqenien fizike dhe financiare të shkollës;
- ✓ mirëmbajtja e objekteve shkollore ndikon mbi dukjen e objektit, funksionimin e pajisjeve, shëndetin e nxënësve dhe personelit dhe zhvillimin e cilësor të procesit mësimor;
- ✓ për mirëmbajtjen e objekteve shkollore nevojiten mjete financiare;
- ✓ organizimi i realizimit të planifikimit strategjik për mirëmbajtjen e objekteve shkollore është punë ekipore, dhe për këtë arsye nevojitet kontribut dhe ekspertizë e faktorëve të ndryshëm;

*Të punësuarit në shkollë të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtje duhet të:*

- ✓ kuptojnë se ndjekja e një numri të madh procedurash në lidhje me mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe zbatimin e tyre çon drejt mirëmbajtjes së suksesshme;
- ✓ të jenë të gatshëm për trajnim të vazhdueshëm për t'i përmirësuar njohuritë e tyre dhe aftësitë e tyre lidhur me mirëmbajtjen e godinave shkollore;
- ✓ tua përcjellin njohuritë dhe përvojat e tyre të punësuarve të tjerë që të mund edhe ata të ndihmojnë gjatë mirëmbajtjes së objekteve shkollore;
- ✓ të bashkëpunojnë me personat drejtues të cilët i sjellin vendimet buxhetore;
- ✓ të dinë se nevojat për zhvillimin e suksesshëm të procesit mësimor drejtpërdrejt ndikojnë mbi vendimet për mirëmbajtjen e godinave shkollore.

*Mësimdhënësit duhet:*

- ✓ ta ngrenë nivelin e rëndësisë së ndikimit të drejtpërdrejt të mirëmbajtjes së objekteve shkollore mbi procesin mësimor;
- ✓ t'i edukojnë nxënësit se si duhet të sillen brenda dhe jashtë objekteve të sistemit shkollor parauniversitar;
- ✓ t'i bartin pritjet e tyre për atë se si duhet të jenë kushtet e brendshme në sistemin e godinave shkollore parauniversitare, pasi ato ndikojnë mbi përmirësimin e procesit të mësimin për nxënësit;
- ✓ t'i respektojnë procedurat për mirëmbajtje.

*Nxënësit duhet:*

- ✓ t'i konsiderojnë objektet shkollore si mjedis i tyre për mësim dhe zhvillim;
- ✓ të sillen me respekt ndaj pronës shkollore;
- ✓ të krijojnë shprehje pozitive të cilat do t'i pasurojnë përvojat e tyre jetësore.

*Prindërit dhe bashkësia përmes përfaqësuesve tyre në Këshillin shkollor duhet të:*

- ✓ dinë se objektet shkollore janë vend ku krijohen qytetarët dhe liderët e ardhshëm;
- ✓ t'i respektojnë vendimet në lidhje me përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore;
- ✓ të japin kontributin e tyre në procesin e sjelljes së vendimeve në lidhje me mirëmbajtjen e objekteve shkollore, kur të kërkohet një gjë e tillë prej tyre.

- Arsimi është faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, mirëqenies ekonomike, krijimit të paqes dhe sigurisë, zhvillimit të vlerave universale dhe përmirësimin të cilësisë së jetës në nivelin individual, familjar, shoqëror e më tej. Arsimi përveç që është e drejtë njerëzore themelore, ai është motor për zhvillimin ekonomik të vendit ku theksi duhet vënë në arsimimin sa më cilësor sepse ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi këtë zhvillimin;
- Mos-njohja, përshtatja dhe analizimi i zhvillimit të veprimtarisë së menaxhimit dhe administrimit arritjes së objektivave të sistemit të godinave të arsimit parauniversitar ndikon negativisht; në cilësinë e procesin e mësimdhënies e mësimnxënies; në cilësinë e jetës dhe shëndetit të nxënësve, (sepse kanë të bëjnë më ndriçimin, qarkullimin e ajrit, ngrohjen, kondicionimin, hapësirat për nxënës e mësues, hapësirat për proceset ndihmëse, hapësirat për edukim fizik, etj.), në përcaktimin e nevojat për mësues e specialistë të kualifikuar e të trajnuar mirë që garantojnë cilësinë e mësimdhënies nxënies; në përcaktimin e nevojave për fonde për përmirësimin e kushteve të shkollave dhe kompletimi

me laboratorë; përcaktimin e nevojave për pajisje e materiale në laboratorë apo kabinete të lëndëve; përfundimit të investimeve të kryera në vite; krijimin e vështirësive në plotësimin me kurrikula sa më cilësore dhe në zhvillim për të reflektuar në kohë kërkesat dinamike të kohës; etj. ;

- Realizimi i një mjedisi të shëndetshëm nga sistemi i godinave shkollore parauniversitar do të garantonte nxënësve mundësi dhe performancë të mësuarit dhe zhvillimit të tyre kulturor e social. Cilësia e ajrit, ndriçimit, hapësirave, etj., në mjedisin shkollor është shqetësim i veçantë për nxënësit, të cilët kalojnë një kohë të gjatë në shkollë dhe karakteristikat fiziologjike i bëjnë ata një grup veçanërisht të ndjeshëm krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë;
- Ndikimet e dëmshme në shëndet që gjenden në mjediset e mbyllura, ku përfshihen edhe shkollat, ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme dhe kanë efekte shëndetësore, shkollat janë një mjedis veçanërisht problem për këtë grup të popullsisë. Mungesa e studimeve mbi pasojat e tyre në shëndet dhe hartimi i metodologjive të standardizuara për të mundësuar që këto çështje të përquasen në një mënyrë gjithëpërfshirëse duhet të jetë parësore si vlerësim për të ndikuar në politikat e ndryshme vendore lidhur me mjedisin e brendshëm të ndërtesave të shkollës që të zbatojnë veprime të matshme me qëllim arritjen e objektivave për një proces cilësor mësimdhënie e mësimnxënie.;
- Matja e objektivave duhet të sigurojnë në mënyrë koherente dhe gjithëpërfshirëse, drejtimet kryesore dhe strategjitë e parandalimit, kontrollit, rehabilitimit dhe komunikimit për një mjedis të shëndetshëm shkollor të japë këshilla, të cilat mund të konsiderohen të zbatueshme në pjesën më të madhe të mjediseve të shkollave, me qëllim të një qasje parandaluese dhe me kosto efektive, në kuadër të përpjekjeve dhe të kostove shtesë të nevojshme për arritjen e cilësisë në një mjedis shkollor - në kundërshtim me qasjen bazuar te problemi që kërkon zgjidhjen e problemit vetëm pasi ai është shfaqur.;
- Realizimi i objektivave për mjedise të shëndetshme në shkollat duhet të jenë të drejtuara kryesisht tek politikë bërësit si në nivel kombëtar dhe tek ato të pushtetit vendor, me qëllim të përmirësimit të mjedisit shkollor, duke respektuar specifikat (mjedisore, sociale, ekonomike).

Nisur nga gjetjet dhe konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij shërbimi:

## **V E N D O S A:**

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Cilësia e godinave të shkollave parauniversitare”, të ushtruar konkretisht Bashkinë Tiranë, Shkodër, Korçë, Fier, Vlorë, si dhe shtrirjen në Bashkitë Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Kukës, Lezhë..

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

### **Rekomandim 1:**

- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve, MASR dhe qeverinë të marrin masa për përmirësimin e gjithë paketës ligjore në përputhje me kushtet realitetin të kësaj qasje të

re të administrimit, kompetencave, aseteve, burimeve njerëzore dhe financiare të menaxhimit dhe administrimit të sistemit të godinave shkollore parauniversitare.

- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve të hartojnë strategji në rritjen cilësorë të sistemit të godinave shkollore parauniversitare, si baza për një mësimnxënie dhe mësimdhënie në sistemi bashkëkohor të arsimit
- ✓ Bashkia Tiranë dhe Bashkitë e rretheve të marrin masa në përmirësimin e standarde, kritereve normave të përcaktuara për godinat shkollore ekzistuese si dhe ndërtimin e shkollave të reja në përputhje me to të cilat të përmirësojnë:
  - madhësitë e tyre në përputhje me numrin e nxënësve,
  - vendndodhjen e tyre në distanca të papërshtatshme nga fshatrat,
  - kushtet e ndriçimit, ajrimit, ngrohjes, mbrojtje nga zjarri, etj.;
  - laboratorët dhe bazën materiale të tyre që korrespondojnë me kurrikulat;
- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve, MASR në bashkëpunim me qeverinë të marrë masa për krijimin e institucioneve të hartimit të politikave, mbikëqyrjes, monitorimit, të sistemit të godinave shkollore parauniversitare.

### **Menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme**

#### **Rekomandim 2:**

- ✓ Bashkia Tiranë si dhe Bashkitë e vendin të realizojnë planifikim të sasisë dhe vlerës apo (kostos) së mirëmbajtjes, restaurimit dhe të ndërtimeve të reja, për godinat shkollore parauniversitare, të domosdoshme për një zhvillimin normal të procesit mësimor sipas drejtimeve të tij;
- ✓ Bashkia Tiranë si dhe Bashkitë e vendin të realizojnë studime mbi analizën e rentabilitetit dhe të përshtatshmërisë për të gjykuar mbi plotësimin e kënaqësive të palëve të interesit, qeverisë, nxënësve, të rinjve, prindërve, dhe sipërmarrjeve e biznesit në fushën e sistemit të godinave shkollore parauniversitare e cila të bazohet në:
  - parimet e vlerës për para;
  - në përputhshmërinë e sistemit të arsimit me objektivat strategjike kombëtare dhe objektivat strategjike të tij;
  - rentabilitetin ekonomik të mundshëm;
  - aftësinë e sistemit për të tërhequr financime buxhetore e financime private;
- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve dhe Qeverinë të marrin masa për plotësimin e dokumentacionit dhe pajisjen me akteve të pronësisë të institucioneve të arsimit parauniversitar konform legjislacionit në fuqi;
- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve dhe Qeverinë të marrin masa për rritjen e fondeve në përmirësimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare si dhe plotësimin e shkollave me ambiente, pajisjet e mjetet përkatëse për laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, gjeografisë, etj.;
- ✓ Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Bashkitë e rretheve dhe Qeverinë të marrin masa për rritjen e fondeve në krijimin dhe përmirësimin e palestrave, terreneve sportive në territorin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare;

### **Menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme**

### **Rekomandim 3:**

- ✓ Bashkitë në bashkëpunim me MASR, qeverinë, grupet e interesit etj., të studiojnë në krijimin e një klime sa më të favorshme, e afatgjatë në administrimin dhe menaxhimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare, në përputhje me kushtet realitetin, nevojat ku ato veprojnë, përvojave me të mira si dhe standardet e BE.
- ✓ Bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për administrimin e menaxhimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare të punojnë urdhra dhe rregullore për ndarje kompetencash dhe përcaktim rolesh të qarta mes drejtorive të bashkive tjera; në hartimin e politikave të veçanta për matjen dhe përdorimin me ekonomicitet dhe eficence të fondeve që i vihen në dispozicion; krijimin e një qasje analitike llogaridhënëse ne aspektin e gjenerimit dhe përdorimit të matësve për vlerësimin e përshtatshmërisë së rikonstruksioneve, meremetimeve apo investimeve ne sistemin e godinave në raport me objektivat e procesit mësimor apo edhe ato të strategjisë së arsimit parauniversitar; në hartimin e planeve të veprimit në bashkëpunim me sektorin publik dhe privat për sistemin e godinave shkollore parauniversitare;
- ✓ Bashkitë në bashkëpunim me MASR, qeverinë të vënë në prioritet si një nga objektivat kryesore për sistemin e godinave shkollore parauniversitare termoizolimi i tyre nga jashtë me material termoizolues;
- ✓ Bashkitë të marrin masa konkrete për plotësimin e mangësive në sistemin e godinave shkollore parauniversitare krahasuar me normat, standardet dhe kriteret në drejtim të: Kapaciteteve; Madhësive të Klasave; Numër nxënës për Klasë; Kushteve të Ndërtimit; standardeve për ndërtimin e objekteve të ujit dhe kanalizimeve; Hapësirave jo- akademike; Hapësirave sportive; Gjendjes së elektricitetit dhe ndriçimit; Gjendjes së ndriçimit artificial; Sistemeve të Ngrohjes në Ndërtesat e Shkollave; Efikasitetit të energjisë; Burimeve të ngrohjes; Transportit; Mobilimi, orenditë dhe aparaturat në shkolla.
- ✓ Bashkitë të hartojnë plan veprimi afatgjatë për administrimin dhe menaxhimin e sistemit të godinave shkollore parauniversitare sipas nevojave dhe prioriteteve të tyre;

### **Menjëherë dhe në mënyrë të vazhdueshme**

Në përputhje me nenin 30 të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

